



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

I	Data	20.09.2022	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
09	660/01-25524	7.		

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Kaçanik, 20. 09. 2022

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve

1. **Komuna e Kaçanikut- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** duke u bazuar në Rregulloren MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, fton gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, e me bazë në Komunën e Kaçanikut, për aplikim për mbështetje financiare-subvencionim të tyre, programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objektiv zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht kujdesit, evokimit, promovimit të vlerave të luftës së UÇK- së dhe këshillimit të personave-kategorive të dalura nga lufta e UÇK- së.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 4,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 4,000.00 euro.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 11. 10. 2022.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ- të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* web faqja: <https://kk.rks-gov.net/kacanik> te rubrika: **Shpalljet**

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në sportelin nr. 8 te objektit te komunës.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

